

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 11.06.2022

Problemi 1

Bleri shpk është një shitës me pakicë i materialeve të modës për femra. Bilanci i mëposhtëm vërtetues është nxjerrë nga librat kontabël më 31 dhjetor 2021:

	Debi	Kredi
	Eur	Eur
5%Obligacionet (2017)	-	80,000
Shpenzimet administrative	205,000	-
Mbitërheqja bankare (Overdrafti)	-	32,000
Shpenzimet e shpërndarjes	197,000	-
Dividenta e paguar	10,000	-
Rezervat e përgjithshme	-	21,000
Shpenzimet e interesit	13,000	-
Stoqet më 1 Janar 2021	98,000	-
Pasuritë joqarkulluese me kosto		
Toka dhe ndërtesat	185,000	-
Pajisjet dhe makineritë	204,000	-
Zhvlerësimi i akumuluar		
Ndërtesat	-	23,000
Pajisjet dhe makineritë	-	94,000
Aksionet e zakonshme, vlera nominale 0.50€	-	140,000
Të pagueshmet tjera	-	7,000
Të arkëtueshmet tjera	3,000	-
Blerjet	480,000	-
Fitimet e mbajtura	-	61,000
Të hyrat	-	984,000
Premia në aksione	-	3,000
Llogaria e pagueshme	-	59,000
Llogaria e arkëtueshme	109,000	-
	<u>1,504,000</u>	<u>1,504,000</u>

Informatat shitesë

- (i) Stoqet më 31 dhjetor 2021 ishin 105,000€.
- (ii) Vlera e tokës në Bilancin Vërtetues është 135,000€. Toka duhet të rivlerësohet në shumë prej 150,000€ më 31 dhjetor 2021.
- (iii) Zhvlerësimi për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021, është si në vijim:
 - Ndërtesat – 2% në vit me metodën drejtvizore
 - Pajisjet dhe makineritë – 10% në vit duke përdorur metodën e saldove zbritëse. Shpenzimet e zhvlerësimit duhet të përfshihen tek shpenzimet administrative.
- (iv) Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë borxhin e keq 9,000€, i cili duhet të shlyhet dhe të përfshihet tek shpenzimet administrative.
- (v) Drejtorët dëshirojnë të bëjnë një lejim për të arkëtueshmet prej 3%. Korrigjimi duhet të përfshihet te shpenzimet administrative.
- (vi) Më 31 dhjetor 2021, Bleri shpk ka bërë emetim bonus të aksioneve 1 aksion për çdo 20 aksione të mbajtura në dorë. Nuk është bërë asnjë regjistrim korrigjues sa i përket emetimit bonus.
- (vii) Shpenzimet e interesit ishin llogaritur dhe paguar vetëm deri me 30 shtator 2021.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 1 :

- a) Përgatitni Pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 **(15 pikë)**
- b) Përgatitni Pasqyrën e Pozicionit Financiar për Bleri shpk më 31 dhjetor 2021. **(15 pikë)**

Zgjidhja e problemit 1

Bleri shpk Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021		
	Eur000	Eur000
Të hyrat nga shitja		984
KMSH		
Stoqet në fillim	98	
Blerjet	480	
Stoqet në fund	<u>(105)</u>	<u>(473)</u>
Fitimi bruto		511
Minus: Shpenzimet operative		
Shpenzimet administrative (Shënimi)	229	
Shpenzimet e shpërndarjes	<u>197</u>	<u>(426)</u>
Fitimi operativ		85
Shpenzimet e interesit (13 + 1) (Shënimi)		<u>(14)</u>
Fitimi neto		<u>71</u>

Bleri shpk Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021		
Pasuritë jo qarkulluese	Eur000	Eur000
Toka dhe ndërtesat		176
Pajisjet dhe makineritë		<u>99</u>
		275
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	105	
Llogaritë e arkëtueshme	100	
-Lejimet	3	
LL/ A neto	97	
Të arkëtueshmet tjera	<u>3</u>	<u>205</u>
Total pasuritë		<u>480</u>
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	147	
Rezerva e rivlerësimit	15	
Rezerva e përgjithshme	21	
Premia në aksione	0	
Fitimi i mbajtur (61+71-10-4)	<u>118</u>	301

Detyrimet afatgjata		
5% Obligacione(2017)		80
Detyrimet afatshkurta		
Llogaritë e pagueshme	59	
Të pagueshmet tjera (7 + 1)	8	
Overdrafti	32	99
Total Ekuiteti dhe Detyrimet		<u>480</u>

Kalkulimet:

ii) Debi Toka 15,000

Kredi Rezerva e rivlerësimit 15,000

iii) Kosto e ndërtesës:185,000 sipas BV

135,000 Kosto e tokës

50,000

Shpenzimet e zhvlerësimit (Ndërtesa)=2%*50,000=1,000

Shpenzimet e zhvlerësimit (Pajisjet dhe makineritë)=10%*(204,000-94,000)=10%*110,000=11,000

Total shpenzimet e zhvlerësimit=12,000

Toka (Kosto) 150,000

Ndërtesa (Kosto) 50,000

-zhvlerësimi i akumuluar ndërtesa (23,000+1,000) 24,000

VNL e ndërtesës 26,000

Total toka dhe ndërtesa 176,000

Pajisjet dhe makineritë (kosto) 204,000

-Zhvlerësimi i akumuluar pajisjet (94,000+11,000) 105,000

VNL e pajisjeve 99,000

iv) Debi Shpenzimet e borxhit të keq (Përfshihen te shpenzimet administrative) 9,000

Kredi Ll/ A 9,000

v) Lejimet=3%*(109,000-9,000)=3%*100,000=3,000

Debi Shpenzimet e borxheve të dyshimta(Përfshihen te shpenzimet administrative) 3,000

	Kredi	Lejimet
	3,000	

Shpenzimet administrative: 205,000 sipas BV

+12,000 zhvlerësimi

+9,000 borxhi i keq

+3,000 borxhi i dyshimt

229,000

vi) Aksionet e mbajtura në dorë=140,000/0.5=280,000 aksione

1/20*280,000 aks=14,000 aksione

Vlera nominale=14,000 aksione*0.5=7,000 Emetimi

bonus:

Debi Premia në aksione 3,000

Debi Fitimet e mbajtura 4,000

	Kredi Aksionet e zakonshme	7,000
--	----------------------------	-------

vii) Shpenzimet e interesit për obligacionet=5%*80,000=4,000

4,000*3/12=1,000 shtesë për 3 muaj deri më 31 dhjetor 2021

Debi Shpenzimet e interesit 1,000

Kredi interesi i pagueshëm (të pagueshmet tjera) 1,000

Problemi 2

Një kompani ka bërë vlerësimin e stokeve për vitin financiar. Të përfshira në inventarët e tij janë artikujt e mëposhtëm:

- Një tavolinë e cila i kishte kushtuar kompanisë 1,250€. Ky lloj i tavolinës zakonisht shitet për 1,895€ por ishte dëmtuar në vërshime dhe si rezultat do të shitet me çmim dukshëm më të ulët. Pritet të shitet për 450€.
- Një dollap i cili kishte koston 720€ dhe normalisht shitet për 995€. Dollapi është dëmtuar dhe do të kushtojë afërsisht 120€ të riparohet dhe pastaj mund të shitet për 750€.
- Një dollap i cili ishte prodhuar sipas kërkesave të klientit, i kishte kushtuar kompanisë 1,832€ për ta prodhuar. Fakeqësisht klienti kishte falimentuar dhe nuk mund ta blinte dollapin. Për shkak të dizajnit unik, ky dollap nuk do të mund të shitet lehtë. Megjithatë, pas përfundimit të vitit kompania e shiti për 2,250€ por kishte kosto të shitjes 105€ dhe kosto të shpërndarjes (transportit) prej 158€.

Kërkohet:

Paraqitni vlerën me të cilën duhet të përfshihen secilët nga zërat e mësipërm të inventarit, në fund të vitit 2021. (10 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Sipas SNK 2, zërat e stokeve do të vlerësohen si në vijim:

- a) Tavolina: Kosto është 1,250€
VNR: Çmimi i prituri i shitjes 450€
Ky zë duhet të vlerësohet me VNR 450 sepse është më e ulët se kosto
- b) Dollapi: Kosto është 720€
VNR: Çmimi i prituri i shitjes minus kostot e riparimit $750 - 120 = 630$
Ky zë duhet të vlerësohet me VNR 630 sepse është më e ulët se kosto
- c) Dollapi: Kosto është 1,832€
VNR: Çmimi i prituri i shitjes minus komisioni minus kostot e shpërndarjes
 $2,250 - 105 - 158 = 1,987$
Ky zë duhet të vlerësohet me kosto 1,832€

Problemi 3

Genci shpk shet me kredi tek shumica e klientëve. Kompania mban llogarinë kontrolluese të arkëtueshmeve, me qëllim që t'i mbaj në kontrollë sistemin e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme. Në vijim janë paraqitur informatat në dispozicion për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021.

Eur

Saldo në fillim e Llogarisë kontrolluese të arkëtueshme më 1 janar 2021 88,200 (Debi)

Totalet për vitin që përfundon më 31 dhjetor:

Shitjet	310,400
Kthimet e shitjeve	20,600
Zbritjet e lejuara	15,000
Borxhet e paarkëtueshme (të këqija)	3,500
Paraja e gatshme e pranuar nga klientët	292,040
Kundërhyrjet me LL/P	1,050

Lista individuale e klientëve më 31 dhjetor 2021 ka treguar si në vijim:

Eur

KAM Market	14,200
Viva Market	15,000
Albi Market	22,800
Fruits Market	1,400
Maxi Market	<u>8,600</u>
	<u>62,000</u>

Nuk janë barazuar lista individuale me llogarinë kontrolluese të arkëtueshmeve.

Kontrollet e mëtejme kanë zbuluar si në vijim:

- i) Paraja e arkëtuar në shumë prej 600€ është kredituar në llogarinë e KAM Market si 60€.
- ii) Zbritjet e lejuara të paraqitura më lartë, nuk ishin të sakta, ato ishin mbivlerësuar për 960€.
- iii) Kthimi i shitjeve prej 3,200€ nga Viva Market ishte regjistruar saktë në llogarinë individuale të Viva, mirëpo ishte harruar në librin e kthimeve të shitjeve.
- iv) Shitja me kredi/afat prej 4,000€ ndaj Maxi Market ishte regjistruar saktë në librin e shitjeve, por nuk ishte bërë asnjë regjistrim në llogarinë individuale të Maxi Market.
- v) Një çek i pranuar nga Fruits Market për 2,430€ ishte kthyer nga banka sepse i kishte kaluar afati. Nuk ishte bërë asnjë regjistrim për këtë çek të kthyer.
- vi) Është realizuar një shitje me kredi prej 5,200€ ndaj KAM Market, mirëpo nuk është bërë asnjë regjistrim për këtë shitje.
- vii) Paraja e gatshme e pranuar në shumë prej 300€, ishte debituar në llogarinë e Maxi Market.
- viii) Nuk ishte bërë asnjë regjistrim kontra me LL/P në llogarinë individuale të Albi Market në shumë prej 750 € minus zbritja tregtare 8%. Kjo shumë ishte regjistruar saktë në Llogarinë Kontrolluese të Arkëtueshmeve.

Kërkohet:

- a) Përgatitni Llogarinë kontrolluese të Arkëtueshmeve. (11 pikë)
b) Përgatitni korrigjimet në listën individuale të klientëve (9 pikë)
(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

<u>Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve</u>			
	Eur		Eur
Saldo në fillim	88,200	Zbritjet e lejuara (15,000-960)	14,040
Shitjet (310,400 + 5,200)	315,600	Kthimet e shitjeve (20600 + 3200)	23,800
Çeku i kthyer	2,430	Paraja e gatshme	292,040
		Borxhi i keq	3,500
		Kundërhyrjet	1,050
		Saldo në fund	<u>71,800</u>
	<u>406,230</u>		<u>406,230</u>

Korrigjimi i listave individuale

	Eur
Saldo e pakorrigjuar	62,000
i) Gabimi	(540)
iv) Shitjet	4,000
v) Çeku i kthyer	2,430
vi) Shitja	5,200
vii) Gabimi i dyfishtë	(600)
<u>viii) Kundërhyrjet</u>	<u>(690)</u>
Saldo e korrigjuar	71,800

Problemi 4

Bilanci vërtetues i Nara shpk nuk ishte barazuar. Ana kredi e kishte tejkaluar anën debi për 5,760€. Kjo ishte paraqitur në llogarinë pezull. Pas rishikimit, janë zbuluar gabimet e mëposhtme:

- a) Totali i llogarisë së blerjeve ishte nënvlerësuar për 2,000€.
- b) Shitjet me para prej 2,470€ ishin regjistruar duke debituar shitjet për 2,470€ dhe kredituar paranë prej 6,430€.
- c) Znj. Sara, borxhi i së cilës ishte shlyer si borxh i keq gjatë këtij viti, e kishte paguar borxhin total në shumë prej 1,080€. Regjistrimi i vetëm për këtë transaksion ishte regjistrimi në kredi të Llogaritë e arkëtueshme prej 1,080€.
- d) Ishte gjetur në tavolinën e kontabilistit një faturë e telefonit prej 2,250€, e cila nuk ishte regjistruar fare.
- e) Totali i librit të kthimeve të shitjeve ditore ishte mbivlerësuar për 1,280€.
- f) Zbritjet e marra prej 840€ ishin regjistruar duke kredituar llogaritë e arkëtueshme dhe duke debituar zbritjet e marra.
- g) Ishte blerë një makineri në shumë prej 24,300€, e cila ishte regjistruar si shpenzim i riparimit. Politika e zhvlerësimit e kompanisë është të zhvlerësojë makineritë me metodën drejtvizore 10%. Ngarkohet zhvlerësimi i plotë në vitin e blerjes dhe asnjë zhvlerësim në vitin e shitjes.

Kërkohet:

- i) Përgatitni regjistrimet në kontabilitet për t'i korrigjuar këto gabime. **(15 pikë)**
- ii) Përgatitni Llogarinë Pezull. **(5 pikë)**

(Totali: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

i) Regjistrimet në ditar

	Debi Eur	Kredi Eur
1 Blerjet e mallit Llogaria pezull	2,000	2,000
2 Paraja Paraja Shitjet Shitjet Llogaria pezull	6,430 2,470	2,470 2,470 3,960
Ose Paraja Shitjet Llogaria pezull	8,900	4,940 3,960
3 Paraja Llogaria pezull	1,080	1,080
Ll/A Shpenzimet e borxheve të këqija	1,080	1,080
4 Shpenzimet e telefonit Telefoni i pagueeshëm	2,250	2,250

5	Llogaria pezull	1,280	
	Kthimet e shitjeve		1,280
6	Ll/A	840	
	Ll/P	840	
	Zbritjet e marra		1,680
7	Pasuritë jo qarkulluese	24,300	
	Shpenzimet e riparimit		24,300
	Shpenzimet e zhvlerësimit	2,430	
	Zhvlerësimi i akumuluar		2,430

ii)

Llogaria pezull			
	Eur		Eur
Saldo në fillim	5,760	Blerjet	2,000
Kthimet e shitjeve	1,280	Shitjet	3,960
		Paraja	1,080
	<u>7,040</u>		<u>7,040</u>

(Total: 20 pikë)

Problemi 5

Mentori shpk Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor

		2021	2020
	Shenimet	Eur	Eur
Pasuritë joqarkulluese	(i)	16,000	18,000
Psuritë qarkulluese			
Stoqet		15,400	12,000
Llogaritë e arkëtueshme		18,500	22,400
Paraja e gatshme		<u>9,500</u>	<u>5,000</u>
Totali i pasurive qarkulluese		43,400	39,400
Totali i pasurive		59,400	57,400
Detyrimet afatshkurtëra			
Llogaritë e pagueshme		800	12,300
Të pagueshme tjera		2,000	2,500
Tatimi i pagueshëm	(ii)	500	2,000
Kredia afatgjatë		<u>10,000</u>	<u>15,000</u>
Totali i detyrimeve		<u>13,300</u>	<u>31,800</u>
Ekuiteti			
Kapitali aksionar		25,000	20,000
Fitimet e mbajtura		<u>21,100</u>	<u>5,600</u>
		<u>46,100</u>	<u>25,600</u>

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

	Eur
Shitjet	185,000
KMSH	<u>(111,000)</u>
Fitimi bruto	74,000
Shpenzimet administrative	<u>52,000</u>
Fitimi operativ	22,000
Të hyrat nga interesi	3,500
Shpenzimet e interesit	<u>(1,500)</u>
Fitimi para tatimit	24,000
Shpenzimet e tatimit	<u>(8,500)</u>
Fitimi neto	<u>15,500</u>

Shënime shtesë:

i) Lëvizjet në pasuritë jo qarkulluese

Kosto:	Eur
Saldo në fillim	45,000
Blerjet gjatë vitit	10,000
Shitjet	<u>(5,000)</u>
Saldo në fund	<u>50,000</u>

Zhvlerësimi i akumuluar:

Saldo në fillim	27,000
Shpenzimi i vitit	10,000
Shitja	<u>(3,000)</u>
Saldo në fund	<u>34,000</u>
Vlera neto në libra (VNL) e pasurive joqarkulluese	<u>16,000</u>

ii) Tatimi:	Eur
Saldo në fillim	2,000
Shpenzimi i vitit	8,500
Tatimi i paguar	<u>(10,000)</u>
Saldo në fund	<u>500</u>

Pasuritë jo qarkulluese janë shitur në para për 4,000 eur.

Kërkohet

- a) Përgatitni Pasqyrën e rrjedhave të arkës sipas metodës indirekte, sipas kërkesave të SNK7, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

a)

Mentori shpk

Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Aktivitetet operative

	Eur
Fitimi para tatimit	24,000
- Të hyrat nga interesi	(3,500)
+ <u>shpenzimet e interesit</u>	<u>1,500</u>
Fitimi operativ	22,000
Plus Zhvlerësimi	10,000
Minus Fitimi kapital	(<u>2,000</u>)
	<u>30,000</u>
Rritja në stoqe	(3,400)
Zvogëlimi në LL/ A	3,900
Zvogëlimi në LL/ P	(11,500)
Zvogëlimi në të pagueshmet tjera	<u>(500)</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet	18,500
Interesi i arkëtuar	3,500
Interesi i paguar	(1,500)
Tatimi i paguar	<u>(10,000)</u>
Paraja e gjeneruara nga Aktivitetet operative	10,500
Aktivitetet investuese	
Blerja e pasurive	(10,000)
Shitja e pasurive	<u>4,000</u>
Paraja e gjeneruara nga Aktivitetet investuese	<u>(6,000)</u>
Aktivitetet financuese	
Nga emetimi i aksioneve	5,000
Pagesa e kredisë	<u>(5,000)</u>
Paraja e gjeneruara nga Aktivitetet financuese	0
Rrjedha neto e parasë gjatë vitit	4,500
Saldo në fillim e parasë më 1 janar	<u>5,000</u>
Saldo në fund e parasë më 31 dhjetor	<u>9,500</u>